

Kryesoret

Vrasja e dyfishtë në Fier, historia intime e viktimave dhe pistat e dyshuara

E PREMTE 10 SHKURT 2017, 16:30
GAZETA SHQIP

EDMOND HOXHAJ

Dy të rinjtë të cilët u gjetën në vranë mesditën e sotme në afërsi të fshatit Shënpjetër në Bashkinë e Fierit dyshohet se kanë pasur një lidhje jashtëmartesore me njëri-tjetrin. Kjo, pasi nga verifikimet paraprake të policisë rezulton se Drini Derveni 32 dhe Ermira Arapi 29 vjeçe, kanë qenë të martuar me të tjerë persona. Madje, 32-vjeçari mësohet të ketë qenë babai i dy fëmijëve, ndërsa 29-vjeçarja Ermira Arapi nga Gurrëza e Lushnjës ishte nëna e një vaje 5-vjeçare. Burime të "Shqip" pohuan se nga verifikimet paraprake ka rezultuar se lushnjarja 29-vjeçare Ermira Arapi ka qenë e martuar në Fermë-Çlirim të Fierit dhe se bashkëshorti i saj jetonte dhe punonte prej vitesh në Greqi për të mundësuar të mira financiare për familjen e tij. Paraditen e djeshme dyshohet se ajo ka dalë nga shtëpia dhe në shoqërinë e Drinit kanë udhëtuar drejt Darëzezës. Por, rreth orës 11:40 makina e ndalur në aksin rrugor Fier-Hoxharë në afërsi të fshatit Shënpjetër dhe trupat e pajetë të të rinjve janë konstatuar nga perosna të tjerë që udhëtonin aty, të cilët kanë njoftuar menjëherë policinë. Pas mbërritjes në vendngjarje, forcat policore kanë konstatuar se 32-vjeçari i pajetë kishte në dorë një pistoletë tip T.T. .

Hetimet

Nga këqyrja e vendit të ngjarjes dhe trupave të pajetë të dy të rinjve, policia ka ngritur dyshimet se ka qenë 32-vjeçari ai i cili ka vranë fillimisht mikeshën e tij duke e qëlluar në kokë, e më pas veten. Kjo, pasi pistoleta me të cilën është kryer krimi është gjetur në dorën e të riut dhe se goditja në kokën e tij është bërë me puthitje. Për shkak se dy viktimat mendohet se kanë pasur lidhje të fshehtë me njëri-tjetrin, hetuesit e kanë pasur të vështirë të zbulojnë arsyet përse 32-vjeçari mund ta ketë kryer këtë krim të dyfishtë. Kjo, pasi nuk ka pasur dëshmitarë okularë dhe nuk dihen shkaqet që kanë çuar në konfliktin mes dy të rinjve.

Pistat

[caption id="attachment_448231" align="aligncenter" width="537"] Ermira Arapi[/caption]

Ndërkohë, veç pistës paraprake që polcia ka ngritur bazuar në këqyrjen e vendit të ngjarjes dhe të trupave të pajetë të dy viktimave, nuk është përjashtuar edhe pista e ndonjë vrasjeje të mundshme. Burime të "Shqip" pohuan se do të kryhen gjithë ekzaminimet përkatëse për të konkluduar zyrtarisht nëse ka qenë 32-vjeçari Drini Derveni, ai i cili ka shtënë me pistoletë ndaj mikeshës së tij e më pas të ketë vranë veten. Pritet që ekspertët kriminalistikë të verifikojnë nëse në duart dhe parakrahët e të riut ndodhen ose jo grimca të barutit që mbeten aty pas shkrepses së armës. Nëse në dorën e 32-vjeçarit ku u gjet arma e krimit do të gjenden edhe grimca të barutit që duhet të mbeteshin aty pasi të kishte shtënë me pistoletë, atëherë do të konkludohet përfundimisht në pistën e parë. Në të kundërt, mund të ngrihen dyshimet për ndonjë vrasje të mundshme, pohojnë burimet.

10 janar 2017 (gazeta-Shqip.com)

Grupi privat në Facebook

Bëhu pjesë e grupit privat në Facebook për lajme ekskluzive.


Bëhu pjesë >



Kryesoret

Zv/ministria e Shëndetësisë: Bëni kujdes, infektohesh dhe po ta vendosësh maskën gabim


Historia e plotë >



Kryesoret

Shifra rekord/ Në SHBA situata del jashtë kontrollit, 47 mijë te infektuar brenda një dite

Historia e plotë >



Kryesoret

Vaksina kundër Covid-19 mund të mos funksionojë


Historia e plotë >



Kryesoret

Rama, Meta e Basha do të bëhen bashkë më 4 korrik, ceremonia që do marrin pjesë


Historia e plotë >



Kryesoret

Sherri në Bulqizë, policia jep detaje: U sulmuan dy vëllezër me thikë, largohet autori


Historia e plotë >



Kryesoret

Sherr me thika mes të rinjve në Bulqizë, i plagosuri rëndë transportohet me helikopter drejt Tiranës (VIDEO)

Historia e plotë >



Kryesoret

Cristiano Ronaldo magjeps me golin e tij, topi arrin shpejtësinë e 'frikshme' (VIDEO)

Historia e plotë >



Kryesoret

KE harton kornizën e negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, çfarë parashikon

Historia e plotë >

Biznes



Shifrat e frikshme të FMN-së: Çdo shqiptar pritët të varfërohet në 2020-n, të gjithë do humbin...

Historia e plotë >



Boris Johnson po luan me zjarrin

Historia e plotë >




Saga e naftëtarëve të Ballshit, flet avokati:Vendimet gjyqësore në letër, zgjidhja në duart e shtetit

Historia e plotë >



Kërcënimi i ri/ Bankat përpigën t'i mbijetojnë një vale të dytë të Covid-19

Historia e plotë >



Drejtoresha e FMN-së paralajmëron: Kriza aktuale ekonomike, si asnjë tjetër

Historia e plotë >



Ylli Pata

Vilat e Papulit janë kthyer në shqetësim për Bashën!

Historia e plotë >

Denonco

Keni informacion në interes të publikut? Dërgojeni në Shqip duke [klikuar këtu](#).

A mendoni se duhet të sanksionohet vendosja e maskave në Shqipëri?

PO

JO

Mundësuar nga **Mediadesk**



Në Fokus

Vuçiç firmosi me Trump për Kosovën, Putin hakmerret ndaj Serbisë

Historia e plotë >



Në Fokus

Pesha e shqiptarëve/ Lufta mes Trump dhe Biden për 40 mijë vota në Miçig...

Historia e plotë >



BE siguron 400 milionë vaksina anti COVID-19, Shqipëria pret dhuratën nga Europa



Studimi/ Faktori gjenetik madhor për format e rënda të Covid-19 është i trashëguar nga neandertalët



Gjumi i keq ndikon tek qarkullimi i gjakut, ja kujdesi që duhet të tregoni